

UDHËZIM
Nr.37, datë 23.9.2011

**PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2011-2012 NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë, të fillojë më 10 tetor 2011 dhe të përfundojë më 30 shtator 2012.

2. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 7 nëntor 2011 dhe të përfundojë në 30 shtator 2012.

3. Viti akademik 2011-2012 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura”, të fillojë jo më vonë se 2 nëntor 2011 dhe të përfundojnë me realizimin e plotë të programit mësimor në varësi të krediteve të miratuara për programin e studimit.

4. Periudha 24 dhjetor 2011 deri më 3 janar 2012 të jetë periudhë pushimesh për studentët.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) brenda datës 24 dhjetor 2011 një listë të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2011, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja brenda datës 25 janar 2012 u dërgon IAL-ve publike listën përkatëse me numrat e matikulimit të studentëve.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve, listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

7. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi për vitin akademik 2011-2012.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj